

DEGË E BLERTË

BIBLIOTEKA
SHTETIT

084-1
833




ANTOLOGJI E POEZISË SË SOTME ARBËRESHE

*8 JH-1
Ø 33*

DEGË E BLERTË

(ANTOLOGJI
E POEZISË
SË SOTME
ARBËRESHE)



12049

SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHERI»

Zgjedhur dhe përgatitur
nga

**NASHO JORGAQI
HYSEN SINANI**

Redaktor
LUAN REXHEPI

PARATHËNIE

Letërsia arbëreshe i takon atyre rasteve të rralla fatlume, që edhe duke qenë degë e trungut të letërsisë mëmë ka arritur të mbetet ngaherë e gjelbër, duke sfiduar kohën dhe harresën, klimën dhe tokën e huaj. Gjithë historia e saj shekullore është pasqyrë e ndërgjegjes së kombësisë, e individualitetit, e vitalitetit të një populli, tregues i lidhjeve të thella, «të gjakut të shprishur të Arbit» me atdheun e të parëve. Për këtë të vërtetë flet qartë letërsia arbëreshe e shekullit XIX, tra shëgimia madhore e De Radës dhe Darës, e Santorit dhe Serembes, pa të cilën nuk mund të kuptohet tradita jonë letrare e Rilindjes Kombëtare.

Por na gjzon fakti se letërsia arbëreshe nuk

është vetëm ajo që ka hyrë tanimë në historinë e artit e kulturës shqiptare. Letërsia arbëreshe është dhe një realitet letrar i kohës sonë; ajo gjallon e jep fryte, pohon ekzistencën e saj përmes vep-rash e krijimesh me vlerë. Kjo letërsi pasqyron jetën dhe aspiratat e arbëreshëve, merr pjesë në luftën e tyre për ekzistencë, është e angazhuar në përpjekjet fisnike për afirmimin e individualitetit të vet.

Në ditët tona, në mjeshterët e arbëreshëve të Italisë është zgjuar një lëvizje e gjerë kulturore e letrare. Ata nuk e kuptojnë ekzistencën e tyre pa përpjekjet për zhvillimin e kulturës dhe letërsisë me fryshtë e karakter kombëtar.

Lufta për të ruajtur gjuhën amtare, kulturën shpirtërore e materiale, këmbëngulja për të fituar të drejtën e shkollës arbëreshe, mbledhja dhe botimi i folklorit, hulumtimi dhe nxjerrja në dritë e dorëshkrimeve të shkrimitarëve të traditës, harti-mi i historisë së fshatrave, studimet e ndryshme monografike, janë disa nga aspektet kryesore të lëvizjes kulturore-patriotike që zhvillohet në ditët tona nga arbëreshët e Italisë. Kudo në mjeshterët e tyre, në Kalabri e në Sicili, po ndihet zëri i vëllezërve tanë, që përpilen të pohojnë qenien e vetë si etnitet e kombësi. Inteligjencia arbëreshe është në pararojë të këtyre përpjekjeve. Re-

vistat «Vija», «Zjarri», «Kutundi ynë», «Zëri i arbëreshëve» janë kthyer në tribuna të mendimit e të mundit të arbëreshëve patriotë. Parulla e tyre «Një gjak, një gjuhë» është shprehja më kuptimplotë e pozitës së drejtë patriotike, e aspiratës dhe përvojës historike se ekzistenca dhejeta, gjuha dhe kultura arbëreshe nuk mund të merren me mend, pa historinë e kulturën shpirtërore e materiale të të gjithë popullit shqiptar.

Një rol të rëndësishëm në këtë luftë pa dyshim kanë luajtur dhe luajnë shkrimtarët, lot letërsia që ata krijojnë. Fryma e gjallë patriotike, shqetësimi përfat e gjakut të Arbërit dhe pozitën e vështirë të arbëreshit në dhe të huaj, militantizmi dhe lidhja shpirtërore me historinë e atdheut të të parëve, që të marra të gjitha së bashku përbëjnë një vijë të kuqe në letërsinë e traditës, po gjejnë shprehjen e tyre dhe në letërsinë bashkëkohore. Kjo tregon se letërsia arbëreshe jo vetëm nuk ka shtetur, por vazhdon denjësisht traditën, në kushte të tjera, me probleme e shqetësime të kohës së saj. Sigurisht, për arsyen krejt të kuptueshme jo në ato përmasa me ato talente e vlera veprash si letërsia e traditës.

Dihet se lëvizja kombëtare shqiptare u bë shpirti i letërsisë arbëreshe të shekullit të nëntëmbëdhjetë, e cila solli atë kontribut fort të çmuar

për çlirimin kombëtar. Duke u mbyllur kjo epokë, epoka e Rilindjes, u mbyll dhe periudha më e ndritur e letërsisë arbëreshe. E megjithatë, jeta tregon se letërsia arbëreshe nuk u shua. Në kushtet tepër të vështira që erdhën më vonë, duke përballuar synimet dhe veprimet imperialiste të borgjezisë së madhe italiane, duke u gjendur në shtratin e Prokustit të diktaturës së egër fashiste, duke luftuar kundër diskriminimit e pengesave të ndryshme, ajo nuk e pati të lehtë të zhvillohet e aq më tepër të ruajë shtatin madhor të Rilindjes. Ajo diti të gjallojë si ndërgjegje e kombësisë dhe pasqyrë e jetës arbëreshe. Fill pas Luftës së Dytë Botërore do të shohim frytet e para të mundit për t'i mbajtur gjallë burimet e letërsisë arbëreshe. Një nga këto fryte, që i takon kësaj kohe, është përmbledhja poetike e Dushko Vetmos «Burbuqe t'egra» (1946). Po duhet të presim disa vjet që të shohim fryte të tjera. Këto do t'i takojnë fundit të viteve 50 e sidomos viteve 60 e 70. Është një e vërtetë e gjëzueshme se letërsia arbëreshe vitet e fundit ka njojur një prodhimi tari të pasur, krijimi tari kjo, që tërheq vëmendjen, jo vetëm me numrin e autorëve e të vepgrave, po dhe me problematikën dhe shqetësimet bashkëkohore, me atë të vërtetë artistike që di t'i kumtojë e t'i përcjellë lexuesit. Është mjaft po-

zitive që talentet më të mirë të kësaj letërsie krijojnë në gjuhën letrare ose përpinqen në mënyrë të ndërgjegjshme që të shkruajnë në gjuhën e përbashkët, duke iu larguar trajtave të ngushta dhe arkaike, e duke u afruar kështu me letërsinë mëmë. Vetëm një praktikë e tillë do të vinte në jetë parullën «Një komb një gjuhë». Emrat e shkrimtarëve arbëreshë, të Dushko Vëmos e Vorëa Ujkos, të Karmell Kandrevës dhe Lluka Perones, të Agostin Jordanit e Françesko Altimarit janë tanimë të njohur në mes lexuesve. Veprat e tyre përfaqësojnë me nder letërsinë e sotme arbëreshe.

Letërsia bashkëkohore arbëreshe është kryesisht një letërsi poetike. Talentet e saj janë gati të gjithë poetë. Është ky një vazhdim i poezisë së traditës apo dhe shprehje e statit në të cilin ndodhet letërsia arbëreshe në kushtet e reja? Mund të jenë të dyja, po kryesorja është sepse poezia i përgjigjet flakë për flakë jetës, reagon menjëherë ndaj shqetësimeve të kohës. Aq më tepër po të kemi parasysh se poezia e sotme arbëreshe paraqitet kryesisht lirike. Vëmendja e saj është zhvendosur nga tema patriotike në temën shoqërore. Ajo ndjek traditën më të mirë të lirikës së Serembës, poezinë e tij të shqetësuar për fatin e rëndë të arbëreshit, që ndihet përjetësisht i huaj

larg atdheut, por dhe krenar për vendin e të parëve, për origjinën shqiptare, që gjaku i arbërit, sado i shprishur nuk humbet në botën e sotme aq të trazuar.

Heroi i përbashkët i poezisë arbëreshe është njeriu i thjeshtë, punëtor e patriot, i mençur e krenar, që jeton në katundin e tij, por që nuk i shkëput lidhjet shpirtërore me atdheun e të parëve, që di se ç'bëhet në botë. Ai ka një fizionomi të brendëshme të pasur e të pastër, ai ka mbetur human, sado që realiteti borgjez e mundon dhe feja i bie në qafë në forma nga më djalëzoret. Megjithëse vërehen në disa vjersha mendime dhe gjendje pesimiste, nota fetare dhe frymë mistike, prapë duhet thënë se idetë e reja, progresi shoqëror, lufta për një shoqëri të re jo vetëm që nuk janë të huaja, por përbëjnë edhe brendinë themelore në poezinë e sotme arbëreshe.

Letërsia bashkëkohore arbëreshe po bën hapat e veta dhe në fushën e prozës e të dramaturgjisë. Po këto hapa janë më të ngadalshëm dhe frytet më të pakta. Deri më tanjani janë botuar në prozë novela e ndonjë roman, tregime të ndryshme në të përkohshmet letrare, siç kanë parë në to dritën e botimit dhe pjesë të vogla dramatike, por nuk kanë arritur në lartësinë e poezisë. Natyrisht, kjo është çështje kohe. Sepse sukseset e pa-

diskutueshme të poezisë, e cila është, siç dihet, gjinia që prin, na bëjnë të shpresojmë për korrje të mbara dhe në gjinitë e tjera.

Besimi për këto korrje të mbara e të shpejta të vjen i vetvetishëm edhe kur lexon vetëm këtë përbledhje, ku janë përfshirë disa nga krijimet e individualiteteve më të shquara të poezisë së sotme arbëreshe. Për tendencën, rrugën e zhvillimit të poezisë arbëreshe në përgjithësi, si edhe të autorëve në vecanti, flasin edhe disa karakteristika kryesore të përbashkëta në pjesën më të mirë të krijimtarisë së këtyre poetëve.

Pavarësisht nga mosha apo kushtet e formimit të tyre poetik, tema patriotike është trajtuar nga se cili prej tyre, sido që në forma e këndvështrime të ndryshme. Tema shoqërore është gjithashtu mjaft e trajtuar në poezinë më të mirë arbëreshe dhe shpesh e gërshtuar me atë patriotike, përmes një malli a një kujtimi përvendin e të parëve të tyre. Bashkë me motivin e dashurisë, poezia arbëreshe e sotme krijon, si të thuash, trinitetin e saj tematik më të preferuar, më të dukshëm.

Malli për Shqipërinë, për tokën e stërgjyshërvë të tyre është pothuajse një motiv bazë nga lind edhe frysëzimi i parë i poetit arbëresh. Këtë mall për tokën e të parëve e gjen të shprehur kudo, nën

yjet, nën diellin që lind e perëndon, te hëna, dallëndyshet, era dhe të tjera burime fryshtimi, që i sjellin poetit kujtimet e përtejdetit. Këtë karakteristikë e gjen te Dushko Vetmo, ndërsa te Voresa Ujko ky motiv është jo i vecuar, por i lidhur, i ngërthyer me temën shoqërore. Kujtimi, malli për atdheun te ky poet, si edhe tek të tjerë, është i lidhur me agimin e së nesërmes, me ditët që do të vijnë, me dashurinë e madhe për jetën arbëreshe, për traditën dhe të ardhmen e kësaj dege të trungut shqiptar; me dashurinë e pamasë për «këngën arbëreshe» që është e lashtë, bujare, e ëmbël... që «është rrënëjë e fortë»; me dashurinë për gjuhën arbëreshe, «për këtë muzikë», siç e quan poeti. Kurse Lluka Perone e shpreh këtë dashuri nëpërmjet peizazheve dhe përshkrimeve të jetës së fshatit arbëresh, ku trimat, pleqtë, të rinxjtë e të rejat këndojojnë «Skënderbeku një menatë...». Edhe tek Karmell Kandreva tema patriotike është e lidhur me atë shoqërore. Jeta është e zbrazët për poetin arbëresh, por atë ka ç'ta mbushë: është dashuria për gjuhën arbëreshe, për tokën e të parëve, për vajzën arbëreshe, për lulet, manushaqet, që i kujtojnë vendin e stërgjyshërvë, Shqipërinë e sotme, ku poeti sheh ruajtjen dhe ngritjen më lart të traditave më të mira të shqiptarit. Ose te Françesko Altimari në poezinë «Moj nënë

Šhqipëri», ku poeti shpreh idenë se sot ura që i lidh ata me dheun e të parëve është dhe do të jetë nesër e në çdo mot prej «çeliku». Më i qartë dhe më i ngushtë, ky gërshetim i temës patriotike me atë shoqërore duket edhe te poezitë e Xhuzepe Skiro di Modika, ku patriotizmi, dashuria për atdheun stërgjyshor, e lidhur ngushtë me emrin e sotëm të Shqipërisë e çon poetin drejt një mendimi më të përparuar. Arbëreshi këtu nuk është thjesht një ëndërrimtar, por një proletar që lufton për realizimin e aspiratave të tij shoqërore, të cilat i sheh të realizuara tek vëllezërit e tij të gjakut. Prandaj edhe të gjithë luftojnë: bie plaku, vdes edhe i riu, por gjaku i tyre bie në dhe për themelët e një shoqërie të re. Ndërsa Buzëdhëlpri ka një mënyrë të tijën në trajtimin e temës shoqërore, në atë kup-tim që ai e jep gjendjen e mjerë të fshatarit dhe punëtorit përmes ndjenjave të holla të dhimbjes, keqardhjes dhe një stoicizmi që e nënkupton qartë përkohshmérinë e kësaj gjendjeje. Pas tij ndihet e gatshme revolta. Në përshkrimin e jetës së fshatit, tonet e ngrohta të dashurisë për të janë të shkrira me tonet e trishtimit që ndien poeti për gjendjen e mjerë. Kështu i flet poeti mikut të tij, Gjonit, që do t'i këndoje përnatë mjerimit; kështu, me këtë dashuri e dhimbje, i flet edhe punëtorit, të cilit i hap derën dhe e njeh nga duart se cili është. Mllef

i madh shprehet këtu dhe vetëm brenda një nënteksti të dhënë me pak fjalë.

Lirika shoqërore zë një vend të rëndësishëm në poezinë e sotme arbëreshe. Në aspektet, fenomenet, tablotë, që na sjell kjo lloj poezie edhe problematika është e rëndësishme, ndonëse shpesh pa një rrugëzgjidhje. Përmasat që merr mjerimi shoqëror në përshkrimet e fuqishme poetike të Vetmos, për shembull, janë të mëdha. Ato kanë formën e një peizazhi të ftohtë, të bardhë, të akullt nga jashtë, por me një zjarr të tillë të brendshëm që paralajmërojnë diçka: një protestë, një revoltë, një thirrje plot mllif apo edhe një shpërthim. Edhe kur në poezi nuk ka asgjë tjetër veç shiut, vetëtima-ve apo një qiri u në errësirë, poeizashi i Vetmos merr shpesh një domethënie të fuqishme shoqërore nëpërmjet gjendjes së mjerë të heroit lirik. Nganjëherë, kjo gjendje është aq e padurueshme, sa poeti shpërthen i pâpërbajtur me një duf të madh.

Dëshira për të qenë i lirë, për të kënduar i lirë është e gjithëpranishme në poezinë arbëreshe të ditëve tona. Kushtet e shfrytëzimit kapitalist bëhen akoma më të rënda tek arbëreshi që e ndien veten të huaj në atë dhe, ndaj edhe dëshira e lirisë shoqërore tek ai është më e madhe. Etja për të qenë i lirë, për të gëzuar një jetë më të mirë, për të ruajtur zakonet, gjuhën, traditat e lash-

ta të etërve të tyre, të gjitha këto janë ndër shqetësimet e para që e bëjnë poetin arbëresh të thotë fjalën e tij përherë e më me forcë. Si tek të gjithë poetët shqiptarë të çdo kohe, liria është ndër këngët më të dashura për poetët arbëreshë. «Ç'është më e bukur se liria?» pyet Perone, duke e parë atë në një kontekst social.

Megjithëse tematika shoqërore paraqitet tanë për tanë disi e kufizuar, dhe kjo ka arsyet e saj krejt të shpjegueshme, në poezinë e sotme arbëreshe gjen të trajtuara edhe mjafit tema shoqërore që i kapërcejnë caqet e konstatimit të mjerimit social, të dhimbjes së poetit, për këtë gjendje, të pikëllimit të tij etj., duke u ngritur kështu në një stad më të lartë, si te ndonjë poezi e Modikës, apo si te vjersha me problematikë jetësore e Kandrevës «Ndrronjeta». Në këtë poezi autori shpreh plot dhimbje e protestë shqetësimin e tij për rrezikun e asimilit, shqetësim ky që e has, në një formë a tjetër, jo rrallë në poezinë e sotme arbëreshe.

Dashuria në poezinë e arbëreshëve të Italisë paraqitet në një gamë të gjërë. Poezia e dashurisë nuk është thjesht erotike. Poeti arbëresh i këndon bukurisë së punës, bariut, minatorit e sidomos peizazhit, hijeshive të natyrës, hënës, diellit, lumit, malit etj. Dashurinë për jetën e thjeshtë të popullit e shpreh bukur Vorea Ujko në disa vjera-

sha. Poezitë e tij, siç thotë vetë ai, janë ura të pamatura ndërlidhjeje me popullin, me vëllanë arbëresh, me gjuhën e sotme shqipe, me jetën, gëzimin, shqetësimin, me krenarinë e sotme shqiptare.

Shpesh, në poezinë lirike arbëreshe vemë re një prirje të theksuar për ta ngritur në përgjithësim artistik edhe një objekt të thjeshtë estetik, për t'i dhënë karakteristika të tillë metaforike dhe një domethënje alegorike që përkojnë me gjendjen shpirtërore të vet poetit, dhe që shprehin një gjendje të caktuar të mqediseve arbëreshe.

Edhe poezia erotike, në krijimet më të mira, ka një domethënje që lidhet ngushtë me traditën, me konceptimin tradicional shqiptar të së bulurës femërore, që e paraqet përmes imazhesh të së thjeshtës, të së pastrës, të fisnikes. Vajza në erotikën e sotme arbëreshe shpesh është e krahasuar me ngrohtësinë e diellit, me bukurinë rrezatuese të tij, me pastërtinë e ujit të krojeve, me lulet e sapoçelura, me mëngjesin e freskët, me vesën.

Të gjitha këto arritje s'ka si të mos e gëzojnë lexuesin tonë. Ato dëshmojnë për lule të vërteta, plot aromë e ngjyra të poezisë arbëreshe, të kësaj dege të blertë të trungut poetik shqiptar.

**NASHO JORGAQI
HYSEN SINANI**

DUSHKO VETMO
(1914)

Dushko Vëtno, pseudonimi letrar i Françesko Solanos (1914), është nga Frashnica e Kalabrisë. Ka studiuar për gjuhësi e teologji. Njihet si shkrimtar e studiues. Drejtont katedrën e gjuhës e letërsisë shqipe në Universitetin e Kozencës. Është autor i një varg veprash letrare, si i vëllimit poetik «*Bubuge t'egra*», novelave «*Bijt' e Dodonës*», «*Dhaskal Mitri*», romanit «*Akullnajat*», pjesëve dramatike «*E po hëna*», «*Shkretëtira prej guri*», përbledhjes me tre gime «*Vjeshtë e thartë*», «*Tregimet e lëmit*», etj. dhe i disa veprave gjuhësore. Ka vizituari disa herë Shqipërinë.

ATDHEUT

Atdhe! Atdhe! Emër plot ëmbëlsi!
Atdhe! Atdhe! Emër i shuguruam!¹⁾
Emër i kthellë²⁾ pér të cilë duruam,
pér të cilë hilnar³⁾ i madh na dhez në gji.

Ti je pér ne djepa më e para,
e cila posa mëma na merr në dorë,
te kryet ti na shtron lul' e kurorë,
ku të lumura këndojnë e mallshëm zëra.

- 1) I shenjtë
2) I thellë
3) Ylli, kandil, llambë

12049

BIBLIOTEKA F SHTETIT

GJRSKASTER

Nº INV. 78078

Për ty na, o mëmë: gjellën¹⁾ po e dhurojmë,
për ty te lufta nder, lule madhëri
kërkojmë, o mëmë, e dashura Shqipëri,
e prap edhe për ty çdo ditë na rrojmë!

1) Jetën, gjallesën.

HYLL N'ERRESI

Pa gjumë kur mbë shtrat un jam e rri,
një hyllith¹⁾ ndaj dritsores më shikon
e rrezet m'i dërgon me lipisi²⁾
i vetëm tek po viret n'errësi,
mos mallin që ka bjerrë po kërkon?

1) Yllëz, yll i vogël.

2) Me dhimbje, me keqardhje

VAJE NËPËR BORË

I përngulur në të thellshëm qetim,
fle katundi nën borën e bardhë;
hëna e vetshme, me të zbehtë shkëlqim,
gjith pullazet e shpive ka zbardhë.

Vrundullimshëm po nj'ajër fishkallon,
edhe lisat i shkundën me forë.
Një vajtim: na njeri po rënkon,
jashta shpive, mjedis asaj bore!

Po mbaj vesh ësht prej djali ky vaj
i lavosur,¹⁾ që zemrën e copton?

A prej çike që mëmën e saj
s'e ka më, dhe qyteti vajton?

O dyrnja, o dyrnja zemërgurë,
ah! ti fle nën pëlhura e mundashe,
e nuk zgjohet të gjegjesh²⁾ sa zemrur
ësht ky vaj që bën kjo vashë!

Ah! sa ka, po sa ka që pa shpi,
si kjo çupëz pa mëmë e në borë,
duke u dredhur, pa as një dashuri
që t'i mbledhë e t'u hapë një dorë!

1) I plagosur

2) Të shohësh, të dëgjosh, të ndjesh.

K U J T I M E

Kujtime po më çohen tash
nga foshnjeria ime,
dhe druaj se vdekja këtej afër
po fluturon....
E thom se druaj
për mos të thënë se vuaj.

Rrëmbeva dje një cinxër mbi një pishë:
mu si në atë kohë
kur xorrobir¹⁾ akoma i djallosur
nëpër diell unë veja e nëpër vohe²⁾

1) Çapkën,
2) Vapë

duke kapërcyer kusinj,
a nëpër erë
ca herë

me një turlurit¹⁾) ndër dhëmbë
dhe lëshoja këndej e andej ndonjë notë
tek po mundohesha më kot
himnin për ta nxjeirrë
të Skënderbeut...

1) Fyell, pipëz,

SHI NËPËR NATE

Gurron përjashta shiu
në xhamë të dritares duke pikuar
me zhurmë si duke ushtuar
e mbrenda në dhomën time vec qiriu
dridhet me flakë të zbehtë duke ndriçuar
gjithë sendet rrokullim.

E tek po shkundet me një shkreptim
valëviten mbrenda sendet
e jashtë te strehët shiu vjen e dendet.

Veton rrëmbimshëm e gjith bota ndritet,
pastaj gjëmon e bot' e tërë tundullohet.

Ja, si jehonë përmbrenda edhe qiriu
shkrepton e ushtohet si përjashta shiu
dhe flaka duke kërcyer shkëlqen
e hijet e holla lart i kthen.

Pastaj ulet posht e vetëm n'errësi
që botën e ka pështjellë
e shiu mundohet më dhomë si të hyjë,
më i dendur, më i thellë
nëpër xhamë duke pikuar
rrufesë për t'i shpëtuar.

KUR VJESHTA KALON

Pushoi së kënduari dallëndyshja,
e sapo befas ajr'i ftohtë fishkëlloi
la folenë q'e kish lart te kisha
e bashk me motrat nga jugorja shkoi.

Të mërzitura vajtojn'ardhit' e vreshtës
me lesht e gjatë lëshuar përmbi dhe,
molla n'të dridhur kujton-pas vjeshtës
dimri do t'i mbajë me borë e rrëfe.

Në qetsi të shkretuar po përnguletjeta
nën turrë t'ajrit që shkallmon me forë
e drunjtë i trondit e i lë pa fleta.

Dhe shqelmësh së tij e tërë vdes bota
mjerisht, e lart ndër thepa mbuluar me borë
ushtimë shprazën e barinjve tota.¹⁾

1) fyelli

PRANVERË

Le të ulemi së bashkut
përmbi barin e njomë
se po fillon pranvera.

Pemët e pishës së merme
te zalli i detit tonë
vallëzojnë mbi kujtimin
e rërës.

Dy milingona të kuqe
hipur mbi një gjethë lili

të guzuara vozisin mbi pasqyrën
e ujit.

Le të ulemi që të dy
përmbi barin e njomë
se po fillon pranvera.

D E S H I R È

Gëzohet bota me diellin
dhe jeta
vulon.

Harepset lundra me erën
qe e shpie
dhe shket
përmbi valët e lumit,
e lehtë.

Gëzohen djemtë
e këndoijnë

pas ngjyrate të larme
të fluturës së magjepsur
në lulishte.

Harepsen lulet
e çelen
me përkëdheljet e pikëvesavet
të agimit.

Gëzohet tani
edhe qesh
kasollja ime e tërë
në prani
të vetes sate
dhe dera
lulëzon.

Diell për mua ti je
dhe vesë.

ZGJOHUNI, LULE

Zgjohuni, lule,
se ujin do ta gjeni
të firasur.

Zgjohuni, lumenj,
se rrjedhjen do ta gjeni
të ndaluar.

Zgjohuni, eshtra,
se do ta dini kur
ne ju harruam.

Zgjohuni, tallaze,
se do ta dini çka
kini përpirë.

Zgjohuni, male,
se njerëzit do t'i shihni
si janë të ngratë.

Zgjohu dhe ti, hënë,
se do të shikosh si eshtrat
e zbardhën tokën...

NÈSE TI

Nëse ti më shikon,
flutur bëhem
e larme.

Nëse ti mua më flet,
lule bëhem
e bardhë.

Nëse ti pra më do,
bëhem dritë
e vallëzoj
përmbi ballin
përmbi flokët
përmbi qiellin
përmbi tokën.

M E N D O J . . .

Ditë pas dite
mbi gurin i ulur pranë derës së vjetër
mu aty ku ditë pas dite
gjyshi për vjet
po ulej
dhe babai
e mendonin
në hijen e freskët,
kur vapa dhe nxehти përcëllisnin shkëmbirjtë
e mocëm
përballë
dhe era zhurmonte ndër gjethet
e lisit
pranë parkut,

aty edhe unë përsëri
ditë pas dite
me radhë
po tri...
Dhe mendoj...

LLUKA PERONE
(1920)

LLUKA PERONE (1920) është nga Ejanina e Kalarisë. Ka studiuar për drejtësi e gjuhësi frëngje. Është kryesishë poet dhe mbledhës e studiues i folklorit. Veprat e tij më të njohura janë: «*Lule shkëmbi*», «*Hiea e ariut*», «*Vjershë lirije*», «*Dërudhëzë*», përmbledhjet në disa vëllime «*Novelistica italo-albanese*» etj.

MINATORIT

Shkall mbë shkall
zbritshe, o minator,
hilnarin në ball
lopatën në dorë.
Tek errësia e gjellës
minatori shurbej,
për te jeta qe nj'përrallëze
ç'para syvet i shkëlqej.
Kush të mbëjith¹⁾)
me mall në gji
kur dilje në shesh
i tër i zi?

1) Mblidhte

Miniera e shkretë
t'dogji rininë
na shtu¹⁾ n'pikëllim
na mbullijti shpinë.
Moj kush t'pa?
Kush t'dha nj'dorë
llangu²⁾ ka na,
moj minator?
Ti vdiqe në shërbim
e bukurea në ball
s't'u shua, heroi im,
t'dritsoi jetën shkall.
O i dashuri, minator,
vdekja jote m'pikllon,
kujtimi yt, minator,
plagën s'më shron.

-
- 1) Na pushtoi pikëllimi
2) Larg

LARTE PULIN¹⁾

Lartë Pulin
bora mbulon,
aratë mb'kalli
puhia valon.
Ejanit argjendi
plepëtë pasqyrohen
me lule bukurusha
dherat ndrrohen.
Dielli shkrepti
zu e përvëlon
zogu folenë

1) Mali më i lartë i Kalabrißë, që ndodhet afër Frashnicës, Ejaninës etj. (fshatra arbëreshe).

i lumtur gaton.
Vasha e nuse
parverën gëzojnë
e tuke qindisur
vallen këndoijnë
«E Skanderbeku
një menatë...»
Këndoijnë trimatë
gjerë e gjatë.
T'rea e pjaka
pleqë e të ri
këndoijnë me mall
mëmën Arbëri.

VISARI MË I MADH

Liria ka sytë e qiellit
e po mbë zëmër
zjarrin e detit,
C'është më e bukur se liria?

M A N U S H A Q J A

Nën drizat e para
manushaq'e qëndisurë
si nuse e virgjërë
po je e stolisurë.

O lule e bukur,
shumë më pëlqen
nën diellin e dhezur
ti fort shkëlqen.

Nën qiellin e thjellët
të kalthëruar
si vashë arbëreshe
me je e kulluar

Natyra me tyj
e hapur n'agim,
O! sa dritë bën
në kalthërim.

P I K E L L I M I

Çelet agimi
tek dita e kalthër,
po pikëllimi
më grisën gjellën.
Endrronj...
e kërkonj
t'ardhmen e një dorë
çë të më ndihënji...
Por me të vërtet
në mbraztitë pisërore
nuk çonj dorën njerëzore.
Buzë gaze të përqeshura,
vërtetje të pa qënura!
E ëndrra loset...

E pakuptueshmja njerëzore
me shtypën gjellën
si guri arrën.

E tue lënguar pres...
tek drita më e vezulluar,
dorën pa mbëkat
të më shkrinjë
zemrën të helmuar
te ki dhé i trubulluar.

BUZË DETIT

Nata po ra,
Buzë detit qëndroj
e ruanj yjzit të ndriçëm.
Nga deti
si lutësi e lehtë,
valazit me sjellin
shpresën e vllazërisë.
Shkrehet nj'yll
e un shërtonj.¹⁾

1) Psherëtij

DIELLI LLAMBURISËN

Dielli mbi Jonin llamburisën
tokën dritson.

Un hapenj sytë e qeshur diellit të ri
e shpirti gëzon
hapësirën e thjellëtë.

HËNZA I PËRSIELL

Largohen ka zalli llambaret¹⁾
tek hapësira e paçquame t'Jonit.
Dritët e dhezura ninzohen²⁾
ndër valazit shkumzuara
të pambaruara.
Pamje ëndërrje!
Peshkatarët mbitjen rjetët
nd'uji.
O punë e rreptë!
Gjella e lodhurë nga gjumi

1) Llambat, dritat.

2) Pasqyrohen, reflektohen.

e lasur¹⁾) nga varfëria
pret...
e besa po e fshehme
i dritson
shpirtin e tërbuar.
Hënza... i përsiell
të mjerët detarë
njer kur i puthën agimi

1) E këputur, e shkrirë.

VOREA UJKO, pseudonimi letrar i Domeniko Beliqit (1918) nga Firma. Ka studuar për letërsi. Është kryesishë poet. Vjershat e tij janë botuar në librat «Zgjimet e gjakut», «Mote moderne», «Kosovë», «Stinët e mia» etj.

D E R A D E S

Një qetësi èndërrimtare përhapet
gjithnjë në Maqin tënd
në kto mbrëmje therrëse të prillit.
E bukura Kallogre ende sot
me kripin¹⁾ e artë, rrahuur nga era,
e me enën prej balte në krah
vjen me hapa valljeje
tek burimi ku lindi dashuria.
Një tym i ngadalshëm nga furrat e përhita
pështjell kumbanoren bizantine,
dhe atje poshtë përroni
pëshpërit këngën e vet të amshuar.

1) Flokë, flokët.

Ti e ke parë, o katund mrëmësuar,
në këto rrugë të kaltërtë.
Këtu, me çapa të shkurtë e të ngadalshëm,
ai kaloi duke kënduar
dhe gjeti t'ëmblin mister
që përhap mallëngjim.
Natën, nga dritarja
e hapur drejt horizontit
ecënte hëna ushqimtare
për të të kënduar përralla.
E kështu lindi kënga jote,
dhuratë bujare e tokës,
në mes rënkimëvet vetmitare,
e kapërthyer nga kujtime të trishtëme;
i lodhur ulnje kokën
sikur një mbret i mëguar.
Ishnje një greminë e ashpër,
e menjëherë e pe veten të turgulluar¹⁾
dhe nëpër vrimën e një shpërtoje
u shkri gjaku yt,
e nën këmbët e tua lulëzuan lulet.
Pak nga pak dritëza po shuhej,
e vëtmja dëshmi e vëtmisë tënde,
por fytyra jote e vjetër,
me rrudhat e shkaktuara nga koha,

1) Turbulluar.

ishte gjithnjë e ndritshme.
Ti ishnje një pishë e ndezur
për të débuar errësirën e natës.
Ndoshta ishnje një ëndërr!
Oh, njomësi e mshehur,
ti. prisje vetëm këngën
për të lënë pushimin tënd.
Kënga e jote mallëngjimtare
është paralajmërim agimor.
dhe ecë përpara
me shpatullat e gjera të qiellit,
me dëshirën gëzimtare drejt lirimit,
me mësheftësinë e vet të moçme
shtërnguar mirë në thinat.
Na të gjithë ta dëgjojmë zërin,
e të gjithë jemi rrëth e rrotull teje
sikur rrëth zjarrit
malsorët në netët e ftohta.
Të ndëgjojmë: ti merr fluturimin
si një zog i madh qiellor,
e shkon larg, shumë larg,
mbi brigjet e detit tonë.
Ti vete për të pushuar
mbi barin e njomshtë të mëngjesit,
pranë lumejve të përgjumshëm,
mbi shkëmbinjtë e në pyjet,
në fshatrat e djegur nga dielli i përvëluar.

Ti shkon për të takuar
djaloshin tënd Milosaon
që ka kthyer tek e bukura e vet.
A nuk keni dëgjuar or miq?
Dikush ka shkuar pranë nesh
e lehtas na ka përkitur me flatrat e veta,
tani na duket si të ringjallshim!
Për së shpejti do të agojë dita.

KËNGË ARBËRESHE

Ti vjen nga deti i kaltër
e sjell në sy
qiej të largët.
Ti vjen nga toka
ku fjalët janë të lashta
posi zakonet e vallet
bujare si gjaku yt,
t'ëmbla si mallëngjimi,
të ngurta si puna jote.
Ti jeton dhe ecën
dhe nuk çuditesh
se të lindin në gojë
si lule në mëngjes.

.

Ti vjen nga toka
q'askush s'e zotëroi.¹⁾
Ti je si gur lumi
ku shket stuhia,
i rrahur nga deti
i tronditür nga toka.
Unë i njoh stinët e tua:
një stinë e shkëlqyer
lufta e gjatë
kur e vetme dhelkë
shpata jote në dorë.
Një stinë e gjatë
errësira dhe heshtja.
Ti je mal e lodër²⁾ lufte.
Fryma jote dhe gjaku
kanë shijen e tokës,
fryma jote dhe gjaku
kanë shijen e lisave,
fryma jote dhe gjaku
kanë shijen e maleve,
kanë shijen e luftës,

.

1) S'e mposhti, s'e pushtoi

2) Daulle

Unë i njoh stinët e tua,
zgjimet dhe shijet.
Unë i njoh vjershat e tua,
gëzimet dhe hidhërimet.
Ti je zëri i tokës,
ti je zëri i gjakut,
afsh i vatrës,
oborri i vjetër
ku përhapej agimi.
Ti je përralla e mëmës,
vreshta e babës
dhe për ty do të jetë e ardhmja.

.

Një agim i madh të pret
e do të gjesh fjalët
që tash nuk i thua.
Do të jetë një agim i kthjellët
e gjithçka do të këndoje në diell.
Vreshta, lumi, shtëpia,
zemra jote e fryjtur
do të këndoje në diell.
Ti je rrënje e fortë
e ushtria jote s'ka ushtarë
pse janë të gjithë kapidanë.
Tungjatjeta, more vëlla.

MUZIKE.

Dëgjova muzikën e natës
kur suvala¹⁾ ra
çdo ngjyrë u shua
e hëna u përul
mbrapa lisave.

Këtu unë s'kam shtëpi
dhe nuk ndihem i huaj.
Në ballë do ta puthja
vashën që troket në derë
dhe pyet në gjuhën time
nëse dëshëroj një kafë.
Ndoshta ajo mendon

1) vala, dallga

se gjuhën e kam xënë
për udhëtim nëpër botë
dhe nuk e di fshehtësinë
që çelet nga gjaku.

MBRËMJA

Suvala te zalli i detit
vjen e lehtë'e më puth këmbët,
ashtu vjen mbrëmja
e më puth ëndrrat.
Zemra fluturon e i vete pas
e ruan kur ulet mbi degat,
kur mbëllin syt' e shtëpivet.
Erretjeta!
E derdhet kah hija e saj
kënga e qetm' e ylëzvet¹⁾)
mall' i gjëravet që s'janë.

1) Formë zvogëlimi e yjeve.

SONATE E PARE

Merushe, mos u rrit.
Mos ia shtrij dorën
stinavet të ardhshme
për vallen e gëzueshme.
Mos i vër veshin
yshturavet¹⁾ t'erës
dhe mos e ndjek e padijshme
udhën e lisavet
e fluturimin e zogjvet.
Të gjithë të qellin²⁾ larg

1) Yshtje, shtytje

2) Sjellin

e t  grisin coh z n.¹⁾
Rri gjithmon  k shtu;
lule q  s'u  el,
f rsh llim bilbili,
burim uji t  fresk t,
me veshjen t nde manushaqeje
t  ku nin zohet qielli,
mrekulli e varur
n  rruzh n²⁾ mizore t  dit vet.

1) Fund, fustan
2) Stuhi, shtr ngat 

E MË ZU MALLI MERUSHES

Sot un' u kam bjerrë
në pyllin e syve tënd
e kam dëgjuar tingllimin
e sahatit t'fëminisë time.
Nuk do më të shtyp hundën
mbi kristalin e kohës
me mbrëmjen mbi kurriz,
përse mbanë kullës sate
unë kam gjetë kalthin¹⁾ tim.

1) Këtu është përdorur në kuptimin e *kalthit*, si lojë
e dashur për fëmijët.

K È C I M

Ti që përdridhe në t'ecur
unë t'hodha lakun te vallja
e naze-naze puna jote
e cimba-cimba zemra ime.
U'të dua e ti s'më do,
ti m'do e u's'të dua.
E dora-dora e bukura ime.
U'të dërgova skamandilin¹⁾
skamandilin lara-lara,
ti e shkele e nuk e more;
ti më dërgove brezin ari
brezin ari lara-lara,

1) shaml

un' e shtura e nuk e vura.
E valle-valle, trimi im.
Ti qan dhe unë qesh,
unë qaj dhe ti qesh.
E si kam bëj u'nuk e di
sy ulli, sy ulli.
Por vetëm është faji im
se ti je e bukur
e unë jam trim.

M A L L È N G J I M I

Esht' ora kur mbi malet e mia
blegtorët kanë ndezë zjarrin,
zjarrin në fushoret e malit
ku nata të magjeps.
Përgjon: ato më grishin
dhe unë e njoh rrugën.

MOMENT ARBRESH

E dua kumbanoren bizantine
në mes qielilit të kaltër
që pingultas bie në shpirtin tonë,
ndërsa mbrëmja merr ngjyra manushaqeje
dhe vajza e èndrravet
biseton kokulur
në prakun e derës.
Kështu përgjumshëm e vetmitar
më vijnë para sysh
lëvizjet e fëminisë
dhe fytyra fatkeqe e Gerantinës.
Dhe arrijnë nga largsia e hijevet
troku i kalit të Kostandinit
që qaset me shpatulla vdekjeje.

Dhe një jehonë arbreshe
depërton ajrin e zemrës
e ngjitet përpjetë si mister
me flatrat e veta të lehta
e rrokë kacavarset e murit,
rrok heshtjen,
rrok gjakun tim.

KUJTIMI I MËMËS

Përmbi krahët e erës
kthehem tek ajo mbrëmje
kur n'udhëtimin tim
shëtiste vdekja.
Të gjihtë sahatat qëndruan
e nata me kukuajka plot.
Ati kokulur mbi thronin
thithte llullën e thartë.
Vetëm sytë e tu,
zemra jote e ngrohtë
dhe heshtja e jetës
qe i sprasmi bisedim;
e kam lënë në gjirin tënd
të gjitha mshefsirat e mia.

Tash nuk mendoj sylë
as flokët, as duartë,
por vetëm un' e di
se pas asaj mbrëmjeje
jam një grykë lumi e thatë
e prej dheut tim kanë fluturuar
të gjithë zogjt.
Dhe asnje kalë
më shpie larg
përtej varrit tënd.

KATUND

Tash unë kam arrijtur
te ku çdo rrugë
ka kryqëzuarët e vet
të fryrë prej shiu,
të zhveshur në dheun e grisur
që gjithmonë më vështrojnë.
Çdo gjë u ka humbur
n'ajrin tënd
e zemra ime ësht'një lahutë
e lavosur¹⁾ nga një mijë thikë.
Çdo gjë u ka humbur

1) E vrarë, e plagosur.

n'ajrin tēnd,
por ti ende m'kēndon
pērse je i fortē
si fiisi yt.

VJERSHAT E MIA

Vjershat e mia
përzjerje drite dhe ere,
stuhie dhe qetësie.

Vjershat e mia
kujtim i lagët në gjak
i mbështjellë në ëndërr,
çast i shndritur nga dielli.

Vjershat e mia
kulla dhe piramida
e shkallë të mëdha xhavidhesh¹⁾)
prej ku zbritnin rrötull në det
luledielli.

1) Guackë.

Vjershat e mia
ura t  pamatura nd rlidhjeje.
Vjershat e mia, ti v llau im,
dhe zemra jote.

ÇKA JAM

Thellë brënda meje
po ka një botë e mbytur
anijesh dhe koralesh
prej ku shfaqem i lodhur.
Me siguri përbrenda meje
unë fsheh një tjetër jetë.

V J E R S H E

U kotullova nën lisin e madh
dhe dëgjova vjershën e erës.
Po ishte vjersha e mëmës
nëpër dhomat e ndezura
me dritën e syve të saj.

A R K E O L O G J I

E mbështeta kokën time
në mur pa histori,
po ashtu unë mendoja
si ta ndreqja historinë time.
Në mriz kam ndërtuar
me tullat e murit
dhe me trazimet e gjakut
historinë e popullit tim.

V A L L È Z I M

Në një mbrëmje vere
teposhtë në luginë
e drodha vallen time
me bukurezat në kremte.
Po isha si shenjt
me kurorë drite.
Përpjetë populli im
i lagur hëne
më përshëndeti poet.

K È S H T U


Pas një rrëthlundrimi të gjerë
në fushën e shllimeve,
pas gabimit dhe mohimit
në mriz më pëlqi aromat
e bajgave të qeve
gjatë gjerdheve me diell.

NË MËNGJES

Në mëngjes e takova
fshatarin në fushore
dhe u zhyta në sytë
në oqean të brendshëm
të syve të gjelbër.
Pa asnje fjalë
në mëngjesin e qartë
e nisëm udhëtimin
drejt diellit të largët.
Ne po shkonim
në xhade ngadhnyese
me ne ishte mbledhur
populli i téri.
Në horizont të zjarrtë
një togë shqiponjash.

P R O F I L

Të fotografova në mëngjeset
e gëzueshme nëpër manushaqe,
në diellin e mjesditës
e mendueshme gjatë gjerdheve,
në muzgun e praruar
e mallëngjyeshme nën qipariSET.
Profili yt mori zbulurimet
e të gjitha stileve
dhe ka qenë herë pas here
korintiak e dorik,
romak e arab,
gotik e i rilindjes,
klasik e modern,
i vegjëlisë e perandorak.
Po vetëm një profil më pëlqei
profili i vashave shqipëtare,
profili i tokës sime.



KARMELL KANDREVA
(1931)

KARMELL KANDREVA (1931) nga Çerçeta. Ka studiuar për pedagogji. Është mësues. Njihet si autor i vëllimeve poetike «*Shpirti i arbërit rron*», «*Shpirti i arbërit rron, arbëreshi tregon, II*», «*Shpirti i arbërit rron – vuandega e hershme*» etj. Ka vizituar disa herë Shqipërinë.

MALL PER SHQIPËRI

Kur shkova në Shqipëri
një grusht me dhe
e mblodha në tokë
dhe me shpejtësi
e fusha në xhep
me një mall të thellë,
që s'ka pendë as vizatim
për të bërë një përshkrim...
Në një shishezë pastaj
mirë unë e rregullova
me kujdes
si dhuratë pastaj ia dorëzova
shokëve arbëreshë,
që të çuditur, me sy në lotë

duke shikuar
më kanë thënë:
Ki qenka dheu ynë i mbushur
me gjak, me djersë, me lotë!
Dheu i stërgjyshve tanë
që jetuan me ndër
me trimëri
dhe luftuan
me fanatizëm
me krenari,
që ka shprehur
me të bukura fuqi
për një qikë liri...
Lufta edhe sot vazhdon
me pendë, me pushkë, me shat
koha kalon e ëmbël
me lehtësi,
pjell toka gjithëmonë çdo pasuri,
këndoijnë shqiptarët të gëzuar,
jetojnë me burrëri...

GJUHA ARBËRESHE

Gjuhë e bukur ti je
ndër shertime e ndë hare
ngë të mundi mosnjeri
për shumë mot, mos vdis nani.
Ngrëhi gjithë, o Arbëreshë!
Fitn'¹⁾ je mbrenda, jasht, ndë sheshë
gjuhën ju nëng kin²⁾ t'harroni
edhe të tjerëve kin ja mbësoni.

1) Fliteni

2) Duhet

Dita çë ka t'ju bënj litinj¹⁾
maj²⁾ ndë jetë ka të vinj.
Ju kin të fitni sembr³⁾ di
se si qe njera nani.⁴⁾

-
- 1) Latinë, italianë
 - 2) Kurre
 - 3) Gjithmonë
 - 4) Tani

JETA E MBRAZËT

Kujto sa mot kaloi,
embëlsira ime!
Ç'u e ti ng'u¹⁾ pamë
më në këtë botë:
Sa herë të kam menduar,
i mjeri u!
Të dëshërova shumë,
Qdoherë të mbajta në tru!
Nani ndodhemi bashkë
si dy urë:
Pa mall, pa dashuri,

1) Nuk

në mes t'kësaj rrugë.
Gëzimet, lotët, shërtimet,
Vanë me djallin:
Jemi pjeq:
s'kemi më dëshirë,
s'kemi më mall!
Jeta ç'kemi kaluar
qe shumë e keqe:
Helme, lavoma⁴), dheimbime
na ka dhënë vetë.
Nani dielli ç'perëndon,
këtje, mbi, te mali,
me hjenë e vetë mblonë
kujtimet e thartë
të kësaj jetë
të mbrazët!

SI PIKA LOT TË ZEZA

Në lugaja¹⁾ të gjera
mbretëron ulliri me ngjyra ergjëndi
dhe me pika të zeza,
Çduken lotët e bujkut
ç'i ka nxijtur buhua²⁾ e jetës.

1) Lugina

2) Pluhur i ngritur nga era

MËMA IME

Sa e bukur je ti, mëma ime!
Kur nd'ëndërra më vjen,
në hare, në lot e në shërtimë,
e me sy të çeluj e buzën mbë gaz,
më ruan e më lajmëron se më ke përrëz,¹⁾
se më mendon, se nëng u bëre hi!
Më kapërren zemëra e gëzon
kur xë se mëmat nëng vdesinë kurrë!

1) Pranë

NDERRON JETA

Nëng punon më argalia¹⁾
si një herë tek gjitonia;
Sirkun²⁾ mosnjeri tagjisën,³⁾
vrerën lumi me ngë nisën,
nusen me nëng këndoijnë.
Gjith ganjunt⁴⁾ më nëng arrvojnë⁵⁾
më në derë t'e lulëzojnë;
shpirti ngë hapet në hare
si një herë bëhej mbi dhe!

1) Vegjë

2) Krimb mëndafshi

3) Ushqeu

4) Djemtë

5) Arrijnë

Më ndë dritare nëng rri
një e bukurë arbëreshe
ç'me mall e dashuri mbjonë¹)
ara, fusha e sheshe.
Oj sa bukurë ish një herë
kur mbi botë rrrohnej me ndër!
Shpirti im u zemërua
kur të ndryshme jetën pa:
gjithë zakonet e atdheut,
bota lëtire²) na prishi e rrëmbeu.

1) Mbush

2) Italiane

F U R I Z I¹⁾

Shprishet në ajrin
tingëllimi i këmborës,
haraksën²⁾ dita,
e furizi, me shkpë në dorë,
përciell delet në lugajat
të pjota me bar.
Ato biren në errësinë
e dushkut ç'pështron³⁾
të tërë largësinë e malit.
Atje nëng ka frikë furizi,

1) Bariu,

2) Zbardh, lind dita.

3) Fsheh

përse ka shpirtin t'errët
edhe aì si mali, i ziu!
Dhe hipet... hipet çdoherë më nalt
sa t'i jap bukë ature ç'rroinë në baltë.

H E N E S

Sa na bënë tē bukur dheun
kur nga natë nē qiell ti je,
hënëzë e bukur, ti njeriun
ndihën kur vete mbi dhe.
Ku e dërgon matënet mjeria
o e shtien malli e varfëria!
Na bën malet tē érgjenduar
edhe lumenjet tē kulluar,
na mbjon zemërën me hare
kur dritson¹⁾ rrugën e re.

1) Mbush me dritë

Shpirti ynë bëhet i madh
kur në male perëndon:
E kur botën nëng shëndrisën¹⁾
është mbi dhe njeri ç'shërton²⁾.

-
- 2) Vuan
1) Përhap dritë

SHOKU ARBÈRESH QANË

Kur një vdes ç'ti do mirë,
me dhëmbime zëmërën të mbjon,
e pa paqë qan e shërton
sa i vet ndë shpi qëndron!
E kur shokët të rrin ndaj
sa të një çekë ti të mund harrosh,
tij nga zëmëra e vrar, e shkret
dreq shërtimet dalinë vetë!
E me tij shërton edhe
shoku ç'të do mirë mbi dhe!
Vëtëm mori¹⁾ mund shëronj
gjithë ata ç'në jetë lëngojnë.

1) Moj. (pasthirmë)

M A N U S H A Q J A

Dielli e ka çelur
ndën ferrin e gjelbër.
Vasha ka ndiejtur erën:
Qeshi, dhe gjiri ju ka fryjtur!
Ajo kallëzoj pranverën,
dhe një dëshir pafund
ndë zemërë ju ka zbuluar.
E si manushaqja
shprishi¹⁾ edhe ajo erën e embël...

1) shpërndaj

INJE E ULUR KUR TË PE¹⁾

Inje e ulur kur të pe
ti më ruajtë e gjë më the.
U të ndjeva e ti e di
si t'i ruajta ata di si,
Ula sitë e prana të pe²⁾
plot me gaz e me hare.
Kurmin m'e mbjove me dashuri
e u zbardhëtim na të di.
Kur u ngrëjtë një çik u tunde
zëmërën time ti m'e munde
më ngë qeshe kur kështu më pe
vuajte mallin ndë këtë dhé
e shërtove thellë shumë
plot më mall inje si lum.

-
- 1) Kur të pashë
 - 2) Pranë të pashë


DITA E RE

Sa më harakset dita,
një çik dritë
nga dritarja
mbrenda vjen e hinë:
më siell këngat
e zogjëve ç'gëzojnë,
thirrat e dallandisheve
ç'fjuturojnë
si era në këtë qiell
té thiellët¹⁾ e té kaltër.
Po sa zgjohemi
këto trut e time,

1) Qiell pa re.

më ziejnë si një poçe
me patana¹⁾
dita ç'ka tē më gëzon
më helmon,
paqën më nxier
e zemérën m'e shpon.

1) Patate.



PIETRO NAPOLITANO
(1931)

PIETRO NAPOLITANO (1931) nga Firma. Është mësues. Në arbërisht ka botuar vëllimin poetik «*Nderim Firmës*», kurse në italisht «*Sussuri*» («Fëshfërimë») «*All' ombra dei miracoli*» («Nën hijen e mrekullive») dhe «*Qualcosa si e' fermato*» («*Diçka ndaloj*»)

ÇE KUR IKE

Çë kur ike ti si këtej
u thajtin lulet,
u tha gjithësei.
Vetëm një fjetëz
mëndrëzje
më qindroi,
çë si zëmëra ime
tyj
nëng të harroi.

NDE MJERGULLËT

Ndë mjergullët
unë gjeta merënginë¹⁾)
gë shuajti
harenë time të zbetë.
Nani u ngrys
po u pres përunjësisht
prirjen e dielli.

1) Trishtim, vetmi, qetësi.

PERNJEHERE

Kur luante
më ruante,
te sheshi
më qeshi,
te kroi
qëndroi:
u qasëm
e folëm,
u njohëm.
U flakuam
u fejuam,
u martuam
e kemi një bilë¹⁾)
që duket si yll.

1) Vajzë, bijë.

DIÇKA MUNGON

Eshtë ky
katundi im
Janë këto rrugë
këto shtëpi
këto brinja,
janë këta ullinj
këta lisa,
këto gjineshtra;
është ky qìell
ky diell,
ky dhe
që shoh këtu
e që njihja unë.

Vjen cërtli¹⁾
e bën folenë
te ai vend
që dija unë.
xixillojat
në mbrëmje dalim
dhe luajnë djemtë
si luaja unë.
Gjithëçka është
ashtu si e lashë.
Por këtu mungon diçka
që ishte një herë
e s'është më!
Mungon zëri
i sime amë
që më mua
nuk më thërret.
Nënë
ti nuk më thërret
më mua,
sepsejeta jote.
u mbarua.

1) Cërlë, = lloj zogu.



BUZĘDHELPRI
(1950)

Buzëdhelpri është pseudonimi i AGOSTIN JORDANIT (1950), që lindi në Frashnitë. U diplomua në Fakultetin e Letërsisë të Universitetit të Romës. Është redaktor i revistës arbëreshe «Zëri i Arbëreshëve». Në këtë revistë ka botuar vjershat e tij të para. Ka botuar deri tani dy vëllime me poezi: «HROAZA» (1975) e «HAPA MBI KALLDRËM» (1977).

D O J A

Doj'të dridhja me fjalët e tua
një kurorë,
t'ja shisja ujit
të shurdër.
Doj' t'i vjidhja varfërisë
një lotë ari,
t'ja dhuroja
nji' mëmje pa bij.

FOLEA E SHPRESËS

Dielli
u shua
në burbulim¹⁾ shkëndilash:
e përçolli nata
me të prasmin cicërrim djemsh;
e losi hjea e gjumit
çë qaset.
Bujsku
lajti folenë e shpresës
me lotë dëjersësh,
çë kish vluar²⁾ nën dhritë.³⁾.

1) Gurgullimë, përvëlim, dufmë.

2) Ruajtur

3) Hardhitë

S O N D E

Sonde
të dërgonj një lule,
bujk;
fytoje¹⁾ në vreshtë
afër asaj dhrije
çë s'lidhi vjet.
Mos më thuaj «si më njeh?»:
numërova shërtimet e tua
dhe i vlova²⁾ nën kuponjën³⁾ e madhe,

1) Mbjell

2) I ruajta

3) Zgavër në trungun e një peme

KUJ I KËNDON?

Gjon,
kuj i këndon
sonde?
Atij karkaleci,
çë të këputi gjumin,
nën garoçin¹⁾)
somenatë?
A ndoshta
asaj pjakarushje
së gjitonisë sime,
çë duart lan
ngadita

1) Trung, kërcu.

me lotë varfërije?
Kush do të qanjë
sonde,
Gjon?

PLAKUT JU THAJTIN DUART

Pjëhu¹⁾
u loth tē mbulonjë
ngaherë
ndjenja
çë s'ndérrojnë...
Pjakut
ju thajtin duart
tue kalladhepsur²⁾
nga vit
atë dhrinë e egër
çë i mban mend tē jatin...


1) Pluhuri

2) Tëharr, krasis,

TË NJOHA

Njo,¹⁾ të hapa derën!
Eja e ngroh u afér zjarrit!
Je puntor:
të njoha duart.
Djersët
do të na i thith dheu
menatë.

1) Erdhe (nga *njonj* — vij, arrij)



XHUZEPE SKIRO
DI MODIKA

XHUZEPE SKIRO DI MODIKA, poet nga Siçilia, boton vazhdimisht vjersha në organë të ndryshme letrare arbëreshe. Poezitë e tij të përfshira në këtë antologji janë marrë nga vëllimi «Motive në dy gjuhë».

NJË SHOQËRI E RE

Në prag të Një Majit,
kremtes së madhe të punës,
janë të lumtur punëtorët
të mos janë më nga pronarët
shtypur si një herë
dhe shfrytëzuar.
As një bujar i përkrah.
Te Gjineshtra, si në grevat,
sheh vetëm të varfër mjeruar
me flamuj të kuq
dhe shqiponjën e lashtë
që mposhti
të huajt turq,
Po ja, papritur, nga perëndimi

moti i keq me rrufe dhe gjëma.

Njëra pas tjetrës, si të lëna,

para derëve dalin gratë

tue thirrur bijtë më kot

që janë, më radhë të parë,

plagosur ose vrarë.

Maj një mijë nëntëqind dyzet e shtatë!

Unë pa mëmë, ti pa bij, ai pa tat.

Vdesin pleqtë

dhe brezi arbëresh i ri

por gjaku i tyre

i mprehtë humb mën dhe

për ndërtimin e një shoqërie të re.

M E R Z I M

Qielli
sot vuri një brez resh
të zeza
mbi shpitë tonë.
Jam ulur,
si një herë edhe mëma ime,
afër zjarrit.

Maçja
flë te 'iri, pranë meje,
dhe prapa mive
rrjedh në gjum.
Ngadalë errësira vret
dritën e ditës

dhe humb më poshtë te gjumi
njerëzi.

Vdiset shtu
tue jetuar në mërzim?!..

AFËR NJERËZVE

Bora e dimrit
më shuan ndjenjat
dhe më lë frysën e gjendjes
së ardhshme
ku do të pushonj
afër njerëzve të thjeshtë
që flasin gjuhën time.

Atje
është më pak e thellë
errësira e tokës,
atje
te të varrosurit
po hyn drita
me zërat e vajzave

dhe të djemve
që sjellin tufa lulesh
mbi të keqen vër¹⁾) të prindërve,
atje dua të flë
afër njerëzve që flasin
gjuhën time.

1) varr

ESHTË DEMOKRACI?

Ju të huaj
çë doni nga dheu pa i shërbyer?
Barëra të egëra
e vende vende ndonjë lule të fshehur
Ju të huaj
çë doni nga një vajzë e bukur
pa e krehur?
Mosvërejtje, unë e di.
Ju të huaj çë doni
dhe ju arbëreshë
nga një gjuhë e folur pa njoħuri?
Unë di sa vlen një dhe i shërbyer,
një vajzë e pastër,
një gjuhë e folur dhe të njoħur
nga gjithenjeri.

Ej, vjet bujku ra sëmurë
e vreshta u mblohd me fletë e bar
që rrushi ng' u bë më verë.
Jetojmë në demokraci?
Unë s'them jo
por, veç të tjerave, për pakicat
tue shtypur nyjën e gjashë,
na merr Sëndastinën sot¹⁾
e si kallnj na shkoq
vazhdimisht e lë pa halë.
Eshtë demokraci
ajo që ngos e rjep,
merr e mosgjë jep?

1) Koloni arbëreshë e cila i kalon administrativisht një qarku tjetër me kushte më të vështira publike, komunikacioni etj.

MËRGIM I RI

Dua shtëpitë, dheun, malet,
heshtimin e liqenit
e çdo gjë që të përket, katund bujar
të njerëzve tanë.
Dua gjuhën, zakonet e atërve
dhe nderonj emërin e të Mëdhenjve të tu.
Tani një mërgim i ri më pret:
Nisem
e të lë dhimshuritë më të dashura
për të varrosur gjékund jetën
që mëkot jetova
prapa shqipeve
të Dheut tim të vjetër.

XHUZEPE SKIRO DI MAXHO
(1944)

XHUZEPE SKIRO DI MAXHO (1944) lindi në Pjana deli Albanezi të Sicilisë. Është diplomuar për letërsi e punon si mësues. Ka botuar në mes të tjerash librat: «Nëpër udhët e Parrajsit shqipëtar e t'arbreshë», «Pugare t'reja», «Sunata», «Trima të rinj arbëreshë apo arësyeja e gjërvavet». etj.

I HUAJ

Një bënet i qeshtshëm
e do mirë trenët,
makinët,
mjetet
çë të lidhjën
dheuthit t'ënt.

E bashk mejtimin
e përkohsis
së tanishme.

Por ndofta s'isht vështirë
të rruarit në dhe të tjervet
pë'kë¹⁾ isht i huaj
vetëhes së tij.²⁾

1) Për atë që

2) Kuptimi: në goftë se nuk vlen për veten, nuk vlen
as për atdheun brenda ose jashtë tij.

N D E R R I M

Dashuri rrëpirje
ndër qiel e dhe
metamorfoz' e ujit.

Re
shi
lum i udhës.

Isht m'e bukurë
pas furtunës
pritja
e të kaltërtit.

FLI


U kridhe te dejti
e atje u josa¹⁾
si kripa.

Lëpije bregun
rërën tue përgëzuar.
Më hikjén nga krahët
gumat²⁾
tue shkumuar.

-
- 1) U sosa, u shkriva, u trëta
 - 2) Shkëmbinjtë.

I amshueshëm durim
vetëmësia.

Sa doja të t'shihja
te një mbrëmësor shkelqëzim
t'joseshe, si dielli,
me mua te deti!



KOSMO ROKO
(1925)

KOSMO ROKO (1925) lindi në S. Kozmo Albanezi. Kreu mësimet në vendlindje. Punon si artizan dhe merret me poezi, muzikë dhe organizimin e grupeve folklorike arbëreshe.

G J E L L A¹⁾

Ti je gjella pér ne,
je si dielli pér ne;
na pér tina shërtomi
e të kultomi,

gjegje² More.³⁾

1) Jeta

2) Dëgjo

3) Me «More» poeti nënkupton atdheun e të parëve të
tij

Mbjidhe gjakun për ne
ç'është i shprishur mbi dhe;
na për tina shërtomi
e të kultomi,
gjegje More.

Nëng i këndonjen më mallit
si te moti një herë,
e sa mot na shkoi
si u ndërrua ki dhe,
gjegje More.

Qiell e hanë shkuen
tue vullatur¹⁾ si re
mosnjeri nëng çuen
jemi vet' te ki dhe,
gjegje More.

1) Rrëshqitur

KATUNDI YNÉ

Katundi ynë,
katundi i zgjedhur
ç'ë¹⁾ ki Strihar.

Katundi ynë,
ku lehet malli,
sa i bukur je.

Oj zëmermadh
ç'ë ki Strihar
pjotë me hare
e pjotë me mallë.

1) Që është

Ke dera jote
u bi një degëz
ç'ë pjotë me molla,
ç'e pjotë me mall.

Ka dera jote
u bi një lule
pjotë me ardur¹⁾)
e pjotë me mall.

Katundi ynë,
sa i vikërr²⁾ je.
je pjotë me mall
pjotë me hare.

1) Aromë
2) I vogël

I KËNDOVA . . .

I këndova mallit,
i këndova gjelles,
i këndova udhës
çë më qellën¹⁾ ndë shpi.

I këndova diellit,
i këndova hënëzës,
i këndova dheut
çë bukën m'e dha.

1) sjell, shpie.

I këndova shegës,
i këndova mollës,
i këndova vreshës
çë verën m'e dha.

I këndova motrës,
i këndova vllaut,
i këndova mëmës
për sa të mir më dha.

I këndova lumiit,
i këndova detit,
i këndova erës
çë shëndetin m'e dha.

I këndova borës,
i këndova dimrit,
i këndova verës
që lulen m'e dha.

I këndova mikut,
i këndova shokut,
i këndova Plakut
çë këngën m'e dha...

VINÇENC BELMONTE
(1945)

VINCENC BELMONTE (1945) lindi në fshatin Strigari. Ka kryer studimet për letërsi e filozofi në Universitetin e Romës. Është docent i filozofisë në liceun e Koriljanos të Kalabrisë. Vëllimi i parë poetik është «*Vento di Ponente*» (1973).

DEGË DIMRI

Degë dimri, degë e xheshur¹⁾,
ka tëtimi e ngjerthëlluar,²⁾
sa mbrënda të fryn një avull
i ngrohtë, ka delt të mbjuar
gjella mburon³⁾ e hjeshe⁴⁾
me fjutura e lulëzuar,

1) I zhveshur

2) E ngjethur nga thëllimi.

3) Gufon, buron, rrjedh

4) E hijshme

UDHA E GJËRAVET

Udha e gjëravet — një.

Të shumët i fjandaksën¹⁾ padija.

Shkel prandaj ndieme²⁾ të padëlgashme³⁾
dhe lotë — dishërimë⁴⁾ të dështuar.

Atë çë s'qe mos ndjek me ëndrra të kota...

-
- 1) Fandaks, step, shushat
 - 2) Vetëdije
 - 3) Të pakuptueshme
 - 4) Dëshira

KATE CUKARO
(1955)

KATE CUKARO (1955) Merret me poezi dhe mbledhjen e folklorit. Është bërë e njojur si poeteshë nëpërmjet vjershave të botuara në organet letrare arbëreshe.

MBI FLETAT E HISTORISE

Fati¹⁾ njeriut ka kämbit e glata²⁾
e vete si ajri.

Moti lë mote të tjerë,
gjella lë gjellë.

Njeriu lë bijt e njeriut.
Fati njeriut ecën udhëve.

Duart ndëhen³⁾ me ëndë
ndaj mollës së ndaluar.
Bijt e njeriut

1) Këtu në kuptimin e jetës së njeriut

2) Gjata

3) Ndehen

janë bij të njeriut.
Fati njeriut shkruan rrethe
mbi fletat e historisë.

K A T U N D I T

Me krah të lumtë më mbleth
sa të marr udhën tënde,
e më qeshin me ata sy
të mbëdhenj si qielli jetës.
Po zërin ta ndienj të helmuar,
si një tatë kur vjen i biri
e di se pra¹⁾ ka të ikinj.²⁾
Gjithë bijt tëndë të ikin
e ti nuk mund t'i mbash;

1) Pastaj

2) do të iki

ndën duart ati t'i rrëmbesh,¹⁾
po gishtët fuqi s'të kanë.
E lë të venë e nga herë
të ikin një pjesë gjellë.

1) duhet t'i rrëmbesh

FRANCESKO ALTIMARI
(1955)

FRANCESKO ALTIMARI (1955) nga Shën Mitri. Ka kryer studimet për letërsi shqipe dhe punon si pedagog në Universitetin e Kozencës. Poezitë e tij janë botuar në revistat «Vija, «Zjarri» etj. Ka vizituar Shqipërinë.

MOJ, NËNË SHQIPËRI

Me sa mall, sa dashuri,
ne të shikojmë, moj nënë Shqipëri.
Sot te dheu yt i bekuar
«gjaku i shprishtë» u ka bashkuar:
gjaku arbëresh, gjaku shqiptar,
nuk janë veç, nuk janë të shpërndarë!
E kjo urë që të Adriatiku
rindërtuar ne kemi sot,
do të jetë një urë «çeliku»
si kështu nesër e në çdo mot!
Me sa mall, sa dashuri,
ne të shikojmë, moj nënë Shqipëri.

S A R A N D A

Jehona e një këngë shqipe
përkatëshe
kodrat e tua të stolisur,
moj nuse e Jonit,
e përshkon pas këtë liqen-deti,
ku dritat e larmishme
po ndërthuren
e të gjata pasqyrohen
si Korneta,
në këtë natë të qetë
pa erë e pa suvala,
që dikur,
me mall do të lakmoj...
Lamtumirë, moj Sarandë-nuse!

PERËNDIM VERE

Ishte në verë e perëndonte
dielli
e i kuq pos i zjarri zbriste
pas maleve.
Fusha të djegura gjithë kallame,
qielli me shumë ngjyra shtrohej pa një re.
Një vajzë në dritare shikonte
perëndimin.
e rrezet e sprasme i luanin
mbi flokët.
E skuqur nga dielli
që e uronte duke rënë
ajo vajzë me një mendim:
mendimi i dashurisë së parë.

E M I G R I M I

Ngas pa oreks i vetëm
nëpër rrugët e shtrembëta e të shtrënguara
të katundit tim,
dielli ra prapa maleve
e drita e hënës
pak e pak zgjerohet mbi dhe.
Përpara e prapa meje
mbretëron qetësi varri
e më këllët te zemra
një helm të thellë:
di mirë se nuk është dimri i ftohtë
që mbyll para motit
njjerëzit tek ana e zjarrit:
prapa të tillave dyer të mbyllura
shumë herë ndodhet vetëm ndonjë plakë
afër një djepi.

D A S H U R I

Në «dashnoren» time
mendimet jetës
gjetën një përgjigje:
zhdukën durimet
si dëbora në verë
e ëndrrat e bukura
kështu kthyen në shpresë.
E ne pasurohem
si lulishte në pranverë
duke bërë gati një të ardhme
që ndërton dashuria.

PASQYRA E LËNDËS

DUSHKO VETMO

Atdheut	17
Hyll n'errësi	19
Vaje nëpër borë	20
Kujtime	22
Shi nëpër natë	24
Kur vjeshta kalon	26
Pranverë	28
Dëshirë	30
Zgjohuni lule	32
Nëse ti	34
Mendoj	35

LLUKA PERONE

Minatorit	39
Lartë pulin	41
Visari më i madh	43
Manushaqja	44

Pikëllimi	46
Buzë detit	48
Dielli llamburisën	49
Hënza i përsiell	50

VOREA UJKO

De Radës	55
Këngë arbëreshe	59
Muzikë	62
Mbrëmje	64
Sonatë e parë	65
E më zu malli Merushes	67
Kërcim	68
Mallëngjimi	70
Moment arbëresh	71
Kujtimi i mëmës	73
Katund	75
Vjershat e mia	77
Çka jam	79
Vjershë	80
Arkeologji	81
Vallëzim	82
Kështu	83
Në mëngjes	84
Profil	85

KARMELL KANDREVA

Mall për Shqipëri	89
Gjuha arbëreshi	91
Jeta e mbrazët	93

Si pika lot tē zeza	95
Mëma ime	96
Ndërron jetat	97
Furizi	99
Hënës	101
Shoku arbëresh qanë	103
Manushaqja	104
Inje e ulur kur tē pe	105
Dita e re	106

PIETRO NAPOLITANO

Çë kur ike	111
Nde mjergullët	112
Përnjëherë	113
Diçka mungon	114

BUZËDHELPRI

Doja	119
Folea e shpresës	120
Sonde	121
Kujt i kënd?n?	122
Plakut ju thaitin duart	124
Të njoha	125

XHUZEPE SKIRO DI MODIKA

Një shoqëri e re	129
Mërgim	131
Afër njerëzve	133
Eshtë demokraci?	135
Mërgim i ri	137

XHUZEPE SKIRO DI MAXHO

I huaj	141
Ndërrim	143
Fli	144

KOSMO ROKO

Gjella	149
Katundi ynë	151
I këndova	153

VINCENC BELMONTE

Degë dimri	157
Udha e gjërave	158

KATE CUKARO

Mbi fletat e historisë	161
Katundit	163

FRANÇESKO ALTIMARI

Moj nënë Shqipëri	167
Saranda	168
Perëndim vere	169
Emigrimi	170
Dashuri	171

Dega e blertë. (Antologji e
Poezisë së sotme arbëreshe)
[Red.: L. Rexhepi]. T., «Naim
Frashëri», 1920.

..f.

(B.m.) Ihe

(B.v.) : 891.983(=919.83:45)-1-

822

D 33

